



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 5, datë 31.01.2019

**PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE, NDAJ AGJENTIT NË SIGURIME PRANË
SHOQËRISË SË SIGURIMEVE “ANSIG” SH.A., Z. ASTRIT PUCI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21) të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 246, pikës 3), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me datë 17.12.2018, u depozitua ankesa lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të kryera nga agjenti i licencuar i shoqërisë “Ansig” sh.a., z. Astrit Puci, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Nga shqyrtimi i materialeve të depozituara, si dhe verifikimi në regjistrin elektronik online të shitjes pranë Autoritetit, të kopjes së policës së lëshuar rezultoi se:

- Veprimtaria e shitjes së policave nuk ushtrohet nga agjenti z. Astrit Puci, por nga një person tjetër, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 198, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Polica e sigurimit të detyrueshëm TPL, me numër serie 180353439, lëshohet vetëm në një fletë në excel, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 5, të Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”;
- Kopja e policës së sigurimit të detyrueshëm TPL ka disa mospërputhje me regjistrin elektronik online të shitjes pranë Autoritetit që lidhen me kodin e raportimit, periudhën e mbulimit në policën e lëshuar si dhe primin i sigurimit.

Agjenti ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në pikën 6, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, për agentin në sigurime z. Astrit Puci, licencuar me Vendim Bordi nr. 198, datë 28.12.2017, të pezullohet ushtrimi i veprimtarisë për shitjen e policave të sigurimit për një periudhë prej 6-mujsh.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI